Kronikë

Përrenjas/ Trafikonte armë nga Maqedonia e Veriut në Shqipëri, i fshihte në thasë! Arrestohet 33-vjeçari (EMRI + VIDEO)

Një rast i trafikimit të armëve nga Maqedonia e Veriut drejt Shqipërisë është goditur nga policia. Vihet në pranga një 33-vjeçar që dyshohet se ka trafikuar armët me qëllim shitjen si dhe janë sekuestruar 1 kallashnikov dhe një armë gjahu.

Redaksia
4 Prill, 09:11 | **Përditesimi: 4 Prill, 10:04**

Share

Një rast i trafikimit të armëve nga Maqedonia e Veriut drejt Shqipërisë është goditur nga policia e Elbasanit. 33-vjeçari Shaqir Çela u arrestua pasi dyshohet se se ai i kishte futur në territorin tonë nga Maqedonia e Veriut, nëpërmjet kufirit të gjelbër.

Policia publikoi videon e momentit të arrestimit në flagrancë të 33-vjeçarit nga Prrenjasi, teksa kishte me vete një armë gjahu dhe një armë zjarri kallashnikov, të fshehura në thasë.

Çela u lokalizua nga specialistët për hetimin e trafiqeve në DVP Elbasan.

LEXO EDHE:
Afër kryqëzimit dhe me fushëpamje të kufizuar, momenti kur makina bën parakalim të gabuar në Elbasan

> *'Gjatë operacionit, në fshatin Skroskë, u lokalizua shtetasi Shaqir Çela, i cili kishte me vete, 1 armë zjarri kallashnikov dhe 1 armë gjahu. Nga hetimet e deritanishme dyshohet se ai i kishte trafikuar armët, nga RMV-ja në vendin tonë, nëpërmjet kufirit të gjelbër, me qëllim shitjen në Shqipëri.', thuhet në njoftimin e sotëm të policisë së Elbasanit.*

Ndaj Shaqir Çelës u ngrit akuza "Trafikimi i armëve dhe i municionit" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit" dhe dosja i kaloi prokurorisë së Elbasanit.

Operacioni u kodua 'Border Crossing'.

Sakaq, po vijon puna për dokumentimin e plotë të rastit me qëllim nxjerrjen përpara përgjegjësisë ligjore të personave të tjerë që mund të jenë të përfshirë në trafikun e armëve.

G.K/S.G/Shqiptarja.com

TAG: Prrenjas | Elbasan | Shaqir Çela | trafik armesh

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Dumani raportoi para KLP, ç'vlerësim keni ju për punën e SPAK-ut?

Pozitiv | Negativ | Asnjanës

Lajme të tjera

Peqin/ Dhunuan një 27-vjeçar, një në pranga, një në hetim dhe 4 në kërkim
1 Prill, 10:02

Shkrumbohet një banesë në Elbasan, vetëm dëme materiale
31 Mars, 20:49

Superliga/ Egnatia hedh 'në tapet' Kukësin pas 6 minutash, verilindorët në fundin e renditjes! Sherri bën heroin
29 Mars, 17:00

Vrau bashkëjetuesen me thikë në 2022 në Elbasan, Apeli lë në fuqi dënimin me burg përjetë të Ramiz Micit
29 Mars, 15:48

Trafik armësh nga Shkodra drejt Tiranës, lihet në burg ish-efektivja dhe 4 të rinjtë
28 Mars, 12:57

Elbasan/ 68-vjeçari merret peng, një burrë e një grua e mbyllin në makinë dhe e kanosin për t'i marrë para! Vihen në pranga
28 Mars, 08:56

Dhunë pas ndeshjes Kastrioti-Elbasani, tifozi 30-vjeçari godet me bidon plastik policin, kolegët ndërhyjnë dhe e shoqërojnë
27 Mars, 19:11

'The Sun': Përplasjet e përgjakshme mes bandave shqiptare në Britani! Prokurori Kreshnik Ajazi: Hakmarrjet ndodhin në Shqipëri
27 Mars, 13:00

Qentë kafshojnë të miturin dhe 60-vjeçarin, në hetim dy pronarët
27 Mars, 10:40

Trafiku i armëve, dëshmon ish-efektivja e Burgjeve: Nuk isha në dijeni, do shoqëronim disa persona në Tiranë! 4 të arrestuarit e tjerë 'kyçin' gojën

Sokol Dema

27 Mars, 09:54

VIDEO/ Vrasja e Pjerin Xhuvanit, 3 ekspertët rindërtojnë skenën e krimit në Elbasan
27 Mars, 09:46

Elbasan/ 32 vjeçarja denoncon: Më kanë keqpërdorur të dhënat personale në një faqe online
26 Mars, 11:16

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje